REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË RTSH-së PËR VITIN 2014

Kuvendi i Shqipërisë vëren se:

1. Veprimtaria e RTSH-së, gjatë vitit 2014, është ushtruar në kushtet e mungesës së organeve drejtuese më të larta, si Këshilli Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm, Bordi i Admi-nistrimit, për shkak të mosplotësimit të vendeve vakante në Këshillin e ri Drejtues.

Rrjedhimisht, veprimtaria e RTSH-së, gjatë vitit 2014, është drejtuar konform ligjit nga Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i RTSH-së.

Ndërkohë, nga KDRTSH-ja e mëparshme nuk janë miratuar disa vendime që burojnë nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", pasi ai edhe gjatë vitit 2014 ishte pa mandat të anëtarëve të tij.

2. Kuvendi i Shqipërisë, i ndërgjegjshëm për bllokimin e tejzgjatur dhe të pajustifikuar të procesit zgjedhës të anëtarëve të KDRTSH-së nga ana e tij, shpreh përgjegjshmërinë për të zgjidhur në mënyrë urgjente ngërçin e drejtimit dhe përfaqësimit institucional në RTSH.

3. Procesi i ndërtimit të rrjeteve numerike të RTSH-së është i vonuar dhe afatet e përcaktuara në aktet nënligjore janë shkelur.

Nga të dhënat e raportimit për veprimtarinë e RTSH-së gjatë vitit 2014, Kuvendi konstaton se:

1. Një sërë detyrimesh ligjore nuk janë zbatuar dhe kanë ngecur, për sa kohë janë të varura nga vendimmarrjet e KDRTSH-së, ende i paforma-tuar tërësisht në përbërjen e tij.

2. Ashtu si dhe vitin e kaluar, raporti është konceptuar si një raport tekniko-financiar, ku janë paraqitur shumë të dhëna lidhur me nivelin e të ardhurave të përfituara, shpenzimet përka-tëse, si dhe disa tregues të ofrimit të shërbimeve dhe cilësisë së tyre.

3. Në raport mungojnë të dhëna mbi ecurinë e procesit të digjitalizimit, si dhe të koordinimit për këtë proces me institucione të tjera, si Ministria për Inovacionin dhe AMA.

4. Në raport mungon informacioni për kontrollin e kryer nga KLSH-ja, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ajo.

Kuvendi vlerëson se:

1. RTSH-ja për vitin 2014 ka rritur të ardhurat me 65 për qind, falë shtimit të arkëtimeve nga pagesat për aparatin marrës TV, si pasojë e bashkëpunimit shumë të mirë me OSHEE sh. a.

2. Gjatë këtij viti, RTSH-ja ka rritur cilësinë e programeve të transmetuara si operator publik, me ofrimin e shërbimeve të shumëllojshme audio dhe audiovizive.

3. Transmetimet e paketës digjitale në 5 kanale, nga të cilat 4 në formatin SD dhe 1 në formatin HD, kanë njohur rritje të audiencës.

Për sa më sipër, për vitin 2015, Kuvendi kërkon nga Këshilli i ri Drejtues, pas konstituimit të plotë të tij, të fokusohet në:

1. Emërimin sa më parë të drejtuesve të rinj të RTSH-së, të Bordit të Administrimit dhe të Këshillit për Shikuesit dhe Dëgjuesit.

2. Miratimin e Statutit të RTSH-së.

3. Angazhimin maksimal të të gjitha struk-turave të RTSH-së në procesin e digjitalizimit, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera të ngarkuara me ligj.

4. Mbylljen e suksesshme të kalimit në tran-smetimet numerike, brenda afateve të përcak-tuara, pas nënshkrimit të kontratës nga ana e Qeverisë, që mundëson kalimin në transmetime digjitale të RTSH-së.

5. Organizmin e një fushate të gjerë për infor-mimin e publikut për procesin e digjitalizimit.

6. Përdorimin me efikasitet të plotë të 2 rrjeteve kombëtare, që mundësohet nga tekno-logjia digjitale: në rrjetin e parë, RTSH-ja do të transmetojë programet e saj dhe në rrjetin e dytë,

programet e të gjithë operatorëve privatë televizivë, lokalë dhe rajonalë.

7. Reformimin shumëdimensional të RTSH-së, përmes një platforme gjithëpërfshirëse, që të forcojë statusin publik të saj.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 9.4.2015